

LIGJ
Nr.8347, datë 18.5.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8227, DATË 30.7.1997 "PËR DISA SHTESA E
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË
PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I
GJERË""**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Neni 3, paragrafi i dytë i ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" ", ndryshohet si më poshtë:

"Për aq kohë sa ndaj subjektit të kontrollit apo personit të lidhur me të nuk ka mbaruar kontrolli dhe administrimi sipas këtij ligji, organet gjyqësore nuk fillojnë proceset gjyqësore civile e tregtare, si dhe pezullojnë të gjitha procedurat e ekzekutimit të vendimeve të dhëna më parë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ëitën e dekretimit nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2100, datë 20.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani